



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA SHKODER



Human Rights

Nr. 58/6 Prot

Nr. 198/23 Prot

Shkodër, më 26 .04. 2023

Shkodër, më 26/04/2023

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

**Bashkia e Shkodër** me seli Rr. "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga **Z. Bardh SPAHIA** në cilësinë e Kryetarit së Bashkisë përfaqësuar me Vendimin nr. 93 date 13.04.2023 "Për delegim kompetence" nga Zv/Kryetari **Z.Tonin Dedaj**.

**Shoqata "Në mbrojtje të drejtave dhe lirive të njeriut"**, me seli Rr. "Marin Biçikemi" Shkodër, përfaqësuar ligjërisht nga **Znj. Xhevaire Gjellaj** në cilësinë e drejtores ekzekutive, madhore dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr.F75217108W, me nr NIPT-i L71603453P, themeluar në vitin 2017 sipas vendimit të gjykatës nr. 5568, dt 30.03.2017.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për mbështetje bazën ligjore sikur vijon:

- Ligji nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
- Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 'Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë' të ndryshuar;
- Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", të ndryshuar;
- Ligji nr .10221 , datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" i ndryshuar;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- VKB nr. 1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, të ndryshuar.

## **Duke qerëse:**

**Bashkia Shkodër** mbështet aktivitetet në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut:

- Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve të ofruara për grupet e rrezikuara nga përjashtimi social, dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.
- Mbrojtjen dhe promovimin e vlerave themelore të të drejtave të njeriut.
- Organizimin e aktiviteteve të trajnimit dhe sensibilizimit për çështjet e lidhura me të drejtat e njeriut.
- Mbështetjen e projekteve me fokus përmirësimin e kushteve sociale të komunitetit.

## **Palet bien dakort si në poshtë:**

### **Neni 1 QËLLIMI**

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin me qëllim zhvillimin e aktiviteteve në mbrojtje të individëve dhe grupeve sociale të rrezikuara, promovimin e parimeve themelore të të drejtave e lirive të njeriut, sensibilizimin dhe përgjegjshmërinë sociale.

### **Neni 2 OBJEKTI**

Organizimi i aktiviteteve promovuese, në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në territorin e Bashkisë Shkodër, sipas një kalendarit të bashkëndarë.

### **Neni 3 AFATI I MARRËVESHJES**

Marrëveshja i shtrin efektet e saj që nga momenti i nënshkrimit.

### **Neni 4 GJUHA E MARRËVESHJES**

Gjuha e marrëveshjes është gjuha shqipe.

### **Neni 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BASHKISË SHKODËR**

5.1 Krijimin e kushteve të nevojshme nga ana e administratës së Bashkisë Shkodër për realizimin me sukses të aktiviteteve të shoqatës duke vënë në dispozicion hapësirat/mjedisin e kërkuar si dhe duke asistuar në nevojat logjistike për zhvillimin e aktiviteteve, me dakortësi mes palëve.

- 5.2 Siguron hapësirën/mjedisin e nevojshëm publik për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- 5.3 Promovimin e aktiviteteve të përbashkëta në media dhe në qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Shoqatën "Në Mbrojtje të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.
- 5.4 Vënia në dispozicion për shfrytëzimin e mjediseve publike, për lehtësimin e zhvillimit të aktiviteteve të Shoqatës në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.
- 5.5 Mbështetje administrative për Shoqatën në mbrojtje të drejtave dhe lirive të njeriut në kuadër të sigurimit të ndihmave humanitare të dhuruara nga donatorë të ndryshëm.

#### **Neni 6**

### **TËDREJTAT DHE DETYRIMET SHOQATËS NË MBROJTJE TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT**

- 6.1 Organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me fokus të drejtat dhe liritë e njeriut.
- 6.2 Mbështetjen e individëve ose grupeve të cilët janë të rrezikuar nga përjashtimi social si të persekutuar, burgosur, dhe/ose diskriminuar për shkak të përkatësis raciale, fetare apo politike.
- 6.3 Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të shoqatës që zhvillohen në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, shoqata duhet të kujdeset për vizibilitetin duke përdorur krahas logove të saj dhe të donatorëve të mundshëm, logon e Bashkisë Shkodër, në krye dhe në vende të dukshme.
- 6.4 Sigurimin e ndihmave humanitare që ndikojnë në përrnirësimin e kushteve sociale të njerëzve në nevojë të komunitetit të Bashkisë Shkodër

#### **Neni 7**

### **KOMUNIKIMI**

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

#### **Neni 8**

### **HËRCAKTIMI I NGJARJEVE TË FORCËS MADHORE**

Për efekt të zbatimit të kësaj marrëveshje, forcë madhore do të quhen:

- 8.1 Fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të priteshin që të ndodhnin; kushtet jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufetë, tërmetet, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret apo dhe rrëshqitjet e tokës.
- 8.2 Një akt lufte (qoftë i shpallur apo i pashpallur), pushtim, konflikt i armatosur apo akt i armikut të huaj, bllokadë, embargo, trazira, kryengritje, veprime terroriste ose

ushtarake, çrregullime civile ose sabotime të motivuara politikisht, që tejkalon një periudhë që zgjat më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

## **Neni 9 ZGJIDHJA E MARRËVESHJES**

- 9.1 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njëra - tjetrën me shkrim.
- 9.2 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 9.3 Nëse një ngjarje e forcës madhore vijon apo, sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve, ka të ngjarë të vijojë përtej një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh, Palët mund të vendosin ta zgjidhin këtë marrëveshje ose ta vijnë zbatimin e kësaj marrëveshje, mbi bazën e kushteve të reja të rëna dakord reciprokisht.
- 9.4 Nëse Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje në lidhje me këtë, Pala e prekur, pas kalimit të periudhës së përmendur prej 30 (tridhjetë) ditësh, do të ketë të drejtën ta zgjidhë këtë marrëveshje duke lëshuar një njoftim zgjidhjeje.
- 9.5 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 10 DISPOZITA TËFUNDIT**

- 10.1 Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 2 vjeçare, me të drejtë rinovimi.
- 10.2 Marrëveshja hartohet në tre kopje, nga të cilat njëri e merr Shoqata në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

**KRYETAR**

**ËR BASHKINË SHKODER**

**Bardh SPAHIA**

Perfaqësuar me vendim delegimi



**DREJTORE EKZEKUTIVE**

**ËR SHOQATËN**

“Në Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut”

